

VENDIM
Nr.964, datë 2.7.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 160, DATË 13.2.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2008,
NË MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.160, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Ministrisë së Financave, në numrin total të punonjësve, të miratuar për vitin 2008, t'i shtohen 27 punonjës, për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

2. Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, në numrin total të punonjësve, të miratuar për vitin 2008, t'i shtohen 15 punonjës.

3. Numri total i punonjësve buxhetorë, për periudhën janar-dhjetor 2008, bëhet 104 167 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Gr.	Ministritë/institucionet	Janar-dhjetor 2008
3	Kryeministria	128
	Institucione të tjera qeveritare, nga të cilat:	106
	-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	33
	-Agjencia e Prokurimit Publik	36
	-Grupi i Mbikëqyrjes	8
	-Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	9
	-Agjencia Kombëtare Shoqërisë së Informacionit	20
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nga e cila:	508
	-Drejtoria e Standardeve	18
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, nga e cila:	2 109
	-Bordet e kullimit	650
6	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	1 362
10	Ministria e Financave, nga e cila:	3 135
	-Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1 027
	-Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1 630
	-Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të	22

	Parave	
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	43 220
	-Universitetet	3 833
	- Parauniversitar	38 496
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1 105
13	Ministria e Shëndetësisë	15 408
14	Ministria e Drejtësisë, nga e cila:	4 594
	- Avokati i Shtetit	40
	- Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	400
	- Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	150
15	Ministria e Punëve të Jashtme	188
16	Ministria e Brendshme, nga e cila:	13 065
	- Drejtoria e Rezervave të Shtetit	100
17	Ministria e Mbrojtjes	11 800
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	950
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	155
22	Akademia e Shkencave	45
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	1 415
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	1 401
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	82
50	Instituti i Statistikës	169
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	10
59	Instituti i Rehabilitimit të të Përndjekurve Politikë	25
78	Ministria e Integrimit	77
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
	Total	101 063
	Totali për institucionet e pavarura	3 104
	Totali i punonjësve buxhetorë	104 167